



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

PROGRAMET E KURRIKULËS ME ZGJEDHJE TË GJIMNAZIT

MODULI: Guida Turistike

Tiranë, 2016



PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli	GUIDA TURISTIKE
Qëllimi i modulit	Një modul që zhvillon te nxënësi aftësi për të dalluar rolin dhe rëndësinë e guidës turistike në industrinë e turizmit si dhe me aftësi për përdorimin e teknikave të thjeshta të drejtimit të grupeve turistike.
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi përshkruan rolin dhe vendin e guidës turistike në industrinë e turizmit si dhe rëndësinë për promovimin e vlerave kombëtare (20 orë)</p> <p><i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none">- Kuptimi për kohën e lire dhe turizmin;- Llojet dhe format e turizmit;- Pejsazhit natyror dhe turizmi;- Kultura dhe turizmi;- Llojet dhe format e ndërmarrjeve turistike- Itinerarin, llojet e itinerarit dhe itinerari turistik.- Kuptimi për guidën turistike.- Veçoritë e guidës turistike në raport me format e tjera të guidave- Veçoritë e turistëve sipas llojit.- Komunikimi me turistët. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none">- Pyetje-përgjigje me gojë.- Vëzhgim me listë kontrolli. <p><i>Kriteret e vlerësimit:</i></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të shpjegojë kuptimi për kohën e lire dhe turizmin;- të dallojë llojet dhe format e turizmit;- të shpjegojë lidhjet mes pejsazhit natyror dhe turizmit;- të shpjegojë lidhjet mes kulturës dhe turizmit;- të dallojë llojet dhe format e ndërmarrjeve turistike- të shpjegojë kuptimin për itinerarin.- të dallojë llojet e itinerarit.- të shpjegojë veçoritë e itinerarit turistik.- të shpjegojë kuptimin për guidën turistike.- të dallojë veçoritë e guidës turistike në raport me format e tjera të guidave- të shpjegojë rolin e guides turistike për promovimin e vlerave të vendit- të dallojë veçoritë e guidave turistike sipas llojit.- të shpjegojë cilësitë e guiderit turistik;- të dallojë veçoritë guiderëve turistikë sipas veprimtarisë që ata kryejnë.

-
- të shpjegojë veçoritë e turistëve sipas llojit.
 - të dallojë veçoritë e komunikimit me turistët.
 - të shpjegojë ndjeshmëritë e turistëve sipas prejardhjes kulturore.
 - të shpjegojë veçoritë psikologjike të grupit turistik.;

RM 2 Nxënësi harton itinerarin turistik dhe zbaton në praktikë teknika të drejtimit të grupit turistik (16 orë)

Përmbajtja:

- procedurat për ndërtimin e itinerar turistik për një destinacion të caktuar
- Veçoritë e guidës në këmbë në zona të banuara (qytet, fshat).
- Teknikat e guidimit në zona të banuara (qytet, fshat).
- Veçoritë e guidës në një vend arkeologjik;
- Teknikat e guidimit në një vend arkeologjik
- Veçoritë e guidës në një museum, galeri arti.
- Teknikat e guidimit në një museum, galeri arti
- Veçoritë e guidës në vende të shenjta (kisha, xhami, etj);
- Teknikat e guidimit në vende të shenjta (kisha, xhami, etj);

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të ndërtojë itinerar turistik për një destinacion të caktuar
- të shpjegojë veçoritë e guidës në këmbë në zona të banuara (qytet, fshat).
- të udhëheqë një grup duke zbatuar teknikat e guidimit në zona të banuara (qytet, fshat).
- të shpjegojë veçoritë e guidës në një vend arkeologjik;
- të udhëheqë një grup duke zbatuar teknika të guidimit në një vend arkeologjik
- të shpjegojë veçoritë e guidës në një museum, galeri arti.
- të udhëheqë një grup duke zbatuar teknika të guidimit në një museum, galeri arti
- veçoritë e guidës në vende të shenjta (kisha, xhami, etj);
- të udhëheqë një grup duke zbatuar teknika të guidimit në vende të shenjta (kisha, xhami, etj).

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të

sigurohen dhe materialet e mëposhtme:

- Materiale mbështetëse për turizmin.
 - Katallogë, manuale, udhëzuesë, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

**Udhëzime për
zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në mjedise të shkollës si dhe në vende të ndryshme turistike.
- Për realizimin e modulit nxënësi është i detyruar të kryejë të dyja rezultatet mësimore të parashikuara në modul..
- Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime të shembujve konkretë.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete.
- Njëpërmjet punëve në grup apo të atyre të pavarura nxënësi duhet të aftësohet për të interpretuar dhe përdorur një itinerar turistik si dhe për të demonstruar aftësi të thjeshta të guidimit.
- Për realizimin e linjës së dytë që ka kryesisht karakter praktik duhet të synohet aftësimi i nxënësit për të planifikuar, udhëhequr në mënyrë të simuluar sipas teknikave të dhura një grup (nxënës, mësues, etj).
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për veprimet financiare të parashikuara në modul. **Portofoli i nxënës/it,-es**, sugjerohet si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi dhe informacioni të prindët për progresin e nxënësit.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.